



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

U R D H Ë R

**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË QENDRËS
KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË”**

Nr. 283, Datë 23. 06. 2023

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 21.08.2003, “Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Programit të Transparencës së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, si dhe akteve bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Përditësimin e Programit të Transparencës, me qëllim:
 - Garantimin e njohjes maksimale të të interesuarve me informacion publik,
 - Vënien në dispozicion pa kërkesë paraprake të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa për informacion.
3. Publikimi i Programit të Transparencës në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë www.nationalfilmcenter.gov.al, nën një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”, si dhe në mjediset e pritjes së publikut.
4. Drejtoria e Projekteve dhe Sektori i Shërbimeve të Brendshme të marrin masat për zbatimin sistematik të këtij programi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Eduart MAKRI



Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr.77. Tiranë
Tel. 0422378 004
E-mail: info@nationalfilmcenter.gov.al
www.nationalfilmcenter.gov.al

**PROGRAMI I TRANSPARENCËS
PËR
QENDRËN KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË**

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës autoriteti publik – Qendra Kombëtare e Kinematografisë - QKK, ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së.

QKK do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së AP-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.nationalfilmcenter.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e QKK është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së AP -së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave. QKK ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e QKK dhe përkatësisht: Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, QKK vendos në dispozicion të publikut në faqen e internetit www.nationalfilmcenter.gov.al kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, manuale, dokumenta të tjerë, apo linqe të institucioneve kombëtare, ndërkombëtare dhe subjekteve të regjistruara në QKK, që kanë lidhje me ushtrimin e funksioneve të saj, apo që prekin publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
 - Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të projekteve kinematografike, Vendimet e Këshillit të miratimit të Projekteve, etj.
 - Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
 - Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura për mënyrë të cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të QKK, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
 - QKK, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
 - Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga QKK.
- Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

**IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË
QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË**

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti /përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. Shoqatat e kineastëve Komisionet ne QKK Këshilli i Miratimit të Projekteve	Neni 7/1/a/d	Struktura organizative vendoset e plotë	Menjëherë pas miratimit. Azhurohet sa herë ka ndryshime	Në faqen zyrtare të internetit në menunë "Rreth QKK"	Drejtorja e Projekteve
Akte ndërkombëtare ligje; akte nënligjore; dokument politikash; dokument tjetër	Neni 7/1/b	Ligji "Për kinematografinë" Statuti i QKK Rregullor e e QKK	Menjëherë pas miratimit. Azhurohet sa herë ka ndryshime	Në faqen zyrtare të internetit në menunë "Juridik"	Juristi
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	Adresa e email: info@nationalfilmcenter.gov.al dhe info.qkk@gmail.com gjithashtu, edhe në web page www.nationalfilmcenter.gov.al	Menjëherë pas miratimit. Azhurohet sa herë ka ndryshime	Në faqen zyrtare të internetit në menunë "Rreth QKK"	Drejtorja e Projekteve
Të dhëna për vendndodhjen e	Neni 7/1/ç	Faqja web	Pas miratimit të	Në faqen zyrtare të	Drejtori i Drejtorisë

Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr.77. Tiranë
Tel. 0422378 004

E-mail: info@nationalfilmcenter.gov.al
www.nationalfilmcenter.gov.al

zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit			urdhrit të caktimit të Koordinatorit.	internetit në menunë “Rreth QKK”	së Projekteve
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve	Neni 7/1/d	Rregullorja e QKK	Menjëherë pas miratimit. Azhurnohet sa herë ka ndryshime	Në faqen zyrtare të internetit në menunë “Juridik”	Drejtorja e Projekteve
Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Raportet monitorimi	Periodikisht	Në faqen zyrtare të internetit në menunë “Transparenca”	Spektori i Financës dhe Shërbimeve
Buxheti	Neni 7/1/e	Materiali i buxhetit	Periodikisht	Në faqen zyrtare të internetit në menunë “Transparenca”	Spektori i Financës dhe Shërbimeve
Informacion për procedurat e prokurimit	Neni 7/1/ë	Regjistri i prokurimeve	Periodikisht	Në faqen zyrtare të internetit në menunë “Transparenca”	Spektori i Financës dhe Shërbimeve
Shërbimet e autoritetit për publikun	Neni 7/1/f	Rregullorja e QKK Fatura për arketim	Azhurnohet sa herë ka ndryshime	Në faqen zyrtare të internetit në menunë “Formula r”	Drejtorja e Projekteve

Mbajtja e dokumentacionit nga QKK	Neni 7/1/h	Informacion		Në faqen zyrtare të internetit në menunë "Programi i transparencës"	Arshivistja
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014	Neni 7/1/i	Rregjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Sipas Lidhjes nr. 2	Në faqen zyrtare të internetit në menunë "Programi i transparencës"	Koordinatori
Informacione dhe dokumente që kërkojnë shpesh	Neni 7/1/k	Akte administrative Informacione për rezultatet e konkurseve Urdhra	Menjëherë pas miratimit. Azhurnohet sa herë ka ndryshime	Në faqen zyrtare të internetit në menunë "Formulari Aplikimi" dhe "Formulari Rregjistrimi vjetor" për rregjistrimin	Drejtorja e Projekteve
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Aktet ligjore dhe nënligjore Rregullorja e QKK	Azhurnohet sa herë ka ndryshime	Në faqen zyrtare të internetit në menunë "Formulari" dhe "Juridik"	Drejtorja e Projekteve

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, QKK vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit në

www.nationalfilmcenter.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.